

## 3.5 REDAKTUESI I REGJISTRIMIT

Redaktuesi i regjistrimit është pjesë e ndërfaqes për katalogim, në të cilën redaktohet regjistrimi bibliografik, që do të thotë shënohen ose ndryshohen të dhënat në regjistrim. Me regjistrimet në redaktues mund të kryhen edhe veprime të tjera, p.sh. kopjimi i regjistrimit në bazën lokale të të dhënave. Ky veprim në redaktues aktivizohet përmes metodave të caktuara në menunë **Regjistrimi**. Për regjistrimet ekzistuese disa nga këto metoda mund të përdoren vetëm nëse regjistrimi paraprakisht është shtuar si skedë në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve.

Redaktuesi i regjistrimit më hollësisht është përshkruar në kapitullin 7.